



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. .....<sup>23</sup> Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 21 / 02 / 2024

**VENDIM**

Nr. 06 datë 21 / 02 / 2024

**PËR**

**PROJEKTIN E OBJEKTIT**

**“RIKONSTRUKSIONI I DIGËS SË LIQENIT ARTIFICIAL TË TIRANËS”**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 “Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave” dhe VKM Nr.147, datë 18.03.2004 “Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe Dambave”, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 21.02.2024 mori në shqyrtim dokumentacionin teknik të paraqitur nga UK Tiranë dhe Bashkia Tiranë për Rikonstruksionin e digës së Liqenit të Tiranës e cila administrohet nga UK Tiranë dhe pronare e të cilës është Bashkia Tiranë. Diga e Liqenit të Tiranës me lartësi 17m dhe gjatësi 600m është ndërtuar në vitin 1959 dhe e mbi ngritur në vitin 1962.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se **mungon detyra e projektimit**, projekti nuk është firmosur nga pronari apo shfrytëzuesi i digës si dhe **mungon Raporti i një studio këshillimi me licencë** dhe eksperiencë në fushën e projektimit të digave, të cilat kërkohen në nenin 10 bazuar në VKM Nr. 147 të cituar më lartë.

Gjithashtu, bazuar në nenin 13 të VKM Nr. 147, për rastet e projekteve të riparimit apo përmirësimeve të digës vlejné vetëm kërkesat e nenit 9, pika 1.1 - 1.10 që kanë lidhje me përmirësimin e projektit të zbatimit për miratim teknik në KKDM. Për sa më sipër, anëtarët e KKDM ranë dakord që ti kërkojnë Bashkisë Tiranë dhe UK Tiranë **dorëzimin e një projekti të plotë zbatimi për rehabilitimin e të gjithë sistemit të shkarkimit të digës**, që nga kulla e portave të shkarkimit në digë dhe deri tek pjesa dalëse e këtij sistemi në lumin e Lanës të shoqëruar edhe me një investigim të plotë të të gjithë sistemit duke përfshirë edhe investigimin me CCTV ose metoda investuese moderne brenda kolektorit kryesor si dhe një analizë të qartë të gjendjes aktuale të këtij sistemi, kapacitetit përcjellës të tij dhe përdorimit të këtij sistemi për shkarkimin dhe derdhjen në lumin e Lanës të ujërave të zeza dhe ujërat e bardha në zonën ku kalon ky kolektor. Njëkohësisht, UKT dhe Bashkia Tiranë duhet të përgatisi një projekt të plotë të zbatimit për punimet e rehabilitimit të digës sipas kërkesave të nenit 9 të VKM së cituar më lartë, të shoqëruar me studimet e plota mbështetëse hidrologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike, sizmike, gjeoteknike dhe gjeofizike si dhe një raport të veçantë në lidhje me filtrimet në digë dhe llogaritjet e qëndrueshmërisë së digës duke u bazuar në kërkesat e KKDM të dhëna për digat me rrisht të lartë. Në këtë projekt duhet të jepen masat që duhet të merren për rehabilitimin e digës së liqenit të Tiranës si dhe metodologjia e punës për punimet speciale që parashikohen në projekt. Punimet speciale të propozuara në dokumentacionin teknik të paraqitur janë me kosto shumë të lartë, të pashoqëruara me një metodologji të kryerjes së tyre dhe të pabazuara në projekte të ngjashme në Shqipëri apo në Evropë.

Pas diskutimeve të të gjithë anëtarëve të pranishëm, KKDM:

**VENDOSI:**

- 1- Të miratoj Planin e Gatishmërisë për Emergjencat Civile (PGEC) të shoqëruar me hartën e përmbytyjeve në zonën urbane poshtë digës në rast të prishjes së mundshme të digës si dhe pjesën e projektit për FV të sistemeve të monitorimit të digës. Projekti për FV të sistemeve të monitorimit dhe për Sistemin e Alarmit në digë duhet të zbatohet me prioritet sa më shpejt të jetë e mundur për të realizuar një monitorim cilësor teknik të bazuar në legjislacionin aktual. Ky projekt duhet të shoqërohet edhe me hartimin e Rregullores së shfrytëzimit dhe monitorimit të digës në kushtet aktuale të gjendjes së digës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

2- **Ti kërkoj Bashkisë Tiranë dhe UK Tiranë**

- a) **Të hartoj një projekt të plotë zbatimi dhe të detajuar për rehabilitimin dhe rikonstruksionin e sistemit të shkarkimit të digës duke filluar që nga rehabilitimi i portave të shkarkimit dhe të remontit në kullën që ndodhet në anën e djathtë të digës dhe të vazhdoj deri në pjesën dalëse të ujërave të shkarkimit nga kjo digë deri në lumin e Lanës. Ky projekt duhet të paraprihet nga një **investigim i plotë dhe i detajuar nga UKT** i gjendjes aktuale të portave dhe të kolektorit të shkarkimit të ujërave deri në lumin e Lanës. Gjatë investigimit duhet të identifikohen edhe prurjet e ujërave të zeza dhe ujërave të bardha që derdhen në këtë kolektor. Investigimi i brendshëm i kolektorit kryesor duhet të kryhet me metoda moderne duke përfshirë edhe inspektimin me metodën CCTV dhe bazuar në këtë inspektim duhet të kryhet kontrolli i kapacitetit përcjellës të këtij sistemi duke u bazuar edhe në Vendimin e KKDM Nr.36, datë 25.10.2023 për kontrollin e kapacitetit përcjellës të sistemeve të shkarkimit në digat e mëdha sipas rrishtit të cili në rastin e kësaj dige është i lartë. Projekti i zbatimit për rehabilitimin e portave të shkarkimit dhe të remontit duhet të hartohet në bazë të një detyre projektimi të miratuar nga pronari/shfrytëzuesi i digës dhe të shoqërohet me një metodologji të detajuar të punimeve të kryera si dhe me një analizë tekniko ekonomike për zgjidhjen më efektive.**
- b) **Të hartoj një projekt zbatimi të plotë për rehabilitimin e digës së liqenit të Tiranës të shoqëruar me studimet mbështetëse përkatëse të kërkuara në nenin 9 të VKM së cituar më lartë si dhe raportet hidrologjik, sizmik, gjeologjik, gjeoteknik, gjeofizik dhe relacionin në lidhje me karakteristikat e materialeve të ndërtimit si dhe relacionin dhe llogaritjet përkatëse për verifikimin e qëndrueshmërisë së digës para dhe pas rikonstruksionit të saj. Projekti duhet të hartohet në bazë të një detyre projektimi të plotë të miratuar nga pronari/shfrytëzuesi i digës dhe të jetë i shoqëruar me raportin e një firme këshilluese të licencuar dhe me eksperiencë në fushën e digave, si dhe me një raport teknik të Këshillit Teknik të Bashkisë për miratimin e projektit dhe të masave që janë të nevojshme për rritjen e sigurisë së kësaj dige.**
- c) **Projektet e zbatimit të kërkuara në pikën 2/a,b duhet të dërgohen për miratim pranë KKDM sipas kërkesave të nenin 9, 10, 13 të VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe dambave”**
- d) **Marrjen e masave të duhura për sigurinë e banorëve të zonës poshtë digës në përputhje me hartën e përmytjeve dhe PGEC të miratuar me këtë Vendim.**

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI